



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**SHTOJCË PËR NDRYSHIMIN E DSK-VE TË PROCEDURËS SË KONCENSIONIT
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË SARANDËS (SIA)**

Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me synim nxitjen e konkurrencës mbështetur në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë, vlerëson nevojën e ndryshimit si më poshtë, të një pjese të kriterëve në Dokumentet Standarte të Koncensionit, dhe njëkohësisht të shtyrjes së afatit të dorëzimit të ofertave të procedurës me objekt “Dhënie me koncesion/PPP Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Sarandës (SIA). REF-02135-08-02-2021.

Kjo masë ndërmerret në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe në mbështetje të pikës 2.3.1 të Dokumenteve Standarte “Ndryshimet në Dokumentet e Procedurës Konkurese”

Sa më sipër:

Pika 2.3, Kapaciteti Teknik, pika 2:

ËSHTË:

2. Pjesëmarrje Kontrolluese (*në shoqëri*) / Përfituesi fundor i Kuotave/Aksioneve

Çdo Ofertues duhet të paraqesë strukturën e tij të kapitalit. Kjo strukturë duhet të paraqitet në formë tabelore ku të përcaktohen përqindjet e aksioneve të secilit Aksionar deri tek zotëruesi fundor. Kjo strukturë kapitali duhet të përputhet me përcaktimet për ndarjen e aksioneve siç përcaktohen në Ftesen për Ofertë dhe në Draft Marrëveshjen Koncesionare

BËHET:

2. Pjesëmarrje Kontrolluese (në shoqëri) / Përfituesi fundor i Kuotave/Aksioneve

Çdo Ofertues duhet të paraqesë strukturën e tij të kapitalit. Kjo strukturë duhet të paraqitet në formë tabelore ku të përcaktohen përqindjet e aksioneve të secilit Aksionar deri tek zotëruesi fundor. Kjo strukturë kapitali duhet të përputhet me përcaktimet për ndarjen e aksioneve ashtu siç përcaktohet në dokumentat ligjore të ofertuesve dhe këtyre dokumenteve standarde.

Pika 2.3, Kapaciteti Teknik, pika 6

ËSHTË:

6. Raport me Strukturën bazë të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Ofertuesit të cilët nuk sigurojnë Kapacitetin Teknik të kërkuar në kuadër të këtij Njoftimi siç përmenden, si dhe çdo dokument tjetër në këtë Njoftim, apo nëse dokumenti/tet është / janë në mos përputhje, do të konsiderohen jo të pranueshëm për të vijuar pjesëmarrjen në tender dhe të dhënat e tyre financiare nuk do të vlerësohen.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos- dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushtepër skualifikim.

BËHET:

6. Raport me Strukturën bazë të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” (të ndryshuar), ku është e aplikueshme.

N.B:

- Ofertuesit të cilët nuk sigurojnë Kapacitetin Teknik të kërkuar në kuadër të këtij Njoftimi siç përmenden, si dhe çdo dokument tjetër në këtë Njoftim, apo nëse dokumenti/tet është / janë në mos përputhje, do të konsiderohen jo të pranueshëm për të vijuar pjesëmarrjen në tender dhe të dhënat e tyre financiare nuk do të vlerësohen.
- Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos- dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

PIKA IV.3 AFATI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

ËSHTË:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 04/10/2021 Ora: 12:00 CET. Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 14/10/2021 Ora: 12:00 CET Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

PIKA IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:

ËSHTË:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 04/10/2021 Ora: 12:00 CET Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 14/10/2021 Ora: 12:00 CET Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.